



## Komuna e Shtimës

### Zyra e Prokurimit

Nr. 03 / A / 055

Datë 07 / 10 / 2020

### **KONTRATË PËR SHËRBIM**

**Komuna Shtime** Rr. „Tahir Sinani „ tel 0290-389-016-131 ose 045-444-509 që e përfaqëson Drejtori i Prokurimit z. Muhadin Halili në njëren anë:

dhe

**SIGONI SH.P.K., Gjurakove, Istog,** , përfaqësuesi ligjor „Agron Malsija , tel .044-800-158 ,në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për:

**Rregullimi dhe vendosja e emërtimeve të rrugëve dhe vendbanimeve**

**Prokurimi: 617-20-5317-2-3-6**

**Nr i brendshëm: 617-2020-066-236**

#### **Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kontratës do të jetë :

**Rregullimi dhe vendosja e emërtimeve të rrugëve dhe vendbanimeve**

**1.2 Kontrata hynë në fuqi me 12.10.2020 dhe përfundon me 15.12.2020**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 3 ditë nga data e marrjes së urdhëresës.

1.4 Vendi i kryjes së shërbimeve do të jetë: *Teritori i Komunës së Shtimës*

1.5 Incotermii aplikueshëm do të jetë DDP<sup>1</sup> (Detyra e Dërguar e Paguar).

#### **Neni 2 Ligji i aplikueshëm**

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë

#### **Neni 3 Çmimi**

**Çmimi total i kontratës do të jetë: 1,992.20 €**

**( Një mijë e nëntëqindë e nëntëdhjetë e dy euro e njëzetë centi )**

<sup>1</sup>DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

#### **Neni 4 Pagesat**

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

**Autoriteti Kontraktues do të bëjë pagesën sipas shërbimeve të kryera , në bazë të raportit nga menaxheri i projektit për shërbimin o kryor . OE duhet të sjell faturë të rregullt për secilin shërbim të kryer.**

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

#### **Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën**

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

#### **Neni 6 Kualiteti**

6.1 Kualiteti i *shërbimeve* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

#### **Neni 7 Garancioni**

**7.1 OE është i obliguar që organizimin e manifestimeve ta bëjë konform kësaj kontrate**

#### **Neni 8 Vonesat në ekzekutim**

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [të kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

#### **Neni 9 Inspektimi dhe testimi**

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

#### **Neni 10 Nën-kontraktimi**

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

#### **Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues**

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim

nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

## Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

## Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *gjykatën kompetentë* në pajtim me ligjin e Kosovës.


## Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrine identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën Shqipëne tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Agron Malsija	Emri:	Muhadin Halili
Pozita:	Përfaqësues ligjor	Pozita:	Drejtor i Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	07.10.2020	Data:	07.10.2020
Vula:		Vula:	



Paramasa dhe paralogaria: Vendorsja e shenjave te trafikut dhe te vendbanimeve					
Nr.	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma në €
<i>Shënim: Në të gjitha pozicionet nënkuptohet shërbimet dhe montimi i paisjeve dhe materialeve</i>					
1	Gërmimi i gropës, furnizimi me materiale dhe punimi me beton C-25/30 i bazamentit me dimensione 50x50x50 cm për montimin e shtyllave të emërtimit të rrugëve	Copë	45	6.00 €	270.00 €
2	Furnizimi dhe montimi i shtyllës metalike të zinktuar për montimin e tabelës së emërtimit dhe tabelave tjera të komunikacionit. Dimenzionet: Ø63mm me trashësi të mureve t=2mm dhe lartësi të shtyllës h=2.5 - 3.5m'	Copë	45	7.00 €	315.00 €
3	Furnizimi dhe montimi i tabelave të emërtimit të rrugëve. Tabela duhet të jetë standarte dhe e njëjtë me ato ekzistueset, si dhe të bëhet ankerimi për shtyllat	Copë	10	23.00 €	230.00 €
4	Riparimi dhe montimi i tabelave ekzistuese në shtyllat ekzistuese. Riparimi përfshinë tabelën me emërtim, shtyllën dhe bazamentin e shtyllës	Copë	50	8.50 €	425.00 €
5	Furnizimi dhe montimi i numrave të hyrjeve në bazë të sistemit të adresave. Numrat të jenë të punuar në tabela standarde (të njëjtë me ata ekzistues), ankerimi i tyre me 4 bulona, numrat mund të jenë 1, 2, 3 dhe 4 shifror	Copë	164	2.30 €	377.20 €
6	Furnizimi dhe montimi i shenjave vertikale të komunikacionit (tabela me mbishkrimin e emërtimit të vendbanimeve), tabelat duhet të jenë sipas standardeve teknike të komunikacionit. Dimenzionet, emërtimet e vendbanimeve, forma dhe kualiteti caktohet në bashkëpunim me organin mbikqyrës	Copë	5	75.00 €	375.00 €
<b>Gjithsej:</b>					<b>1,992.20 €</b>

Emri i Kompanisë	"SIGONI SH.P.K
Adresa e Plote	ISTOG
Përfaqësuar Nga:	ISTOG
Emri & Mbiemri	Agron Malsija
Pozita	Perfaqesuers ligjor
Nënshkrimi	
Data	21.09.2020
Vula	

